

EMRAT ETNIK TË POPULLIT SHQIPTAR NË FJALORIN E VUK KARAXHIÇIT*

Latif Mulaku

Fakulteti Filozofik
i Prishtinës

809.198.3—54
KUD 909.198.3:808.6/.62
Punim studimor

Marrë për botim më 21 shtator 1987

Objekt shqyrtimi në këtë punim janë emrat etnikë dhe ktetikë të popullit shqiptar që i ka përdorur në Fjalorin e tij trigjuhësh Vuk Karaxhiçi. Vihet në pah se emrin etnik *Arnaut* dhe rrjedhojat e tij *Arnautin*, *Arnautka* etj., që i kishte shënuar Vuku në pjesën leksikore të gjuhës serbe, i kishte marrë nga turqishtja. Theksohet pastaj se këto forma etnikësh e kishin burimin nga forma e greqishtes *Arvanitis*, *Arbanitis*. Është pasqyruar në këtë studim edhe etniku *Arbanase* (në kuptimin 'shqiptar') dhe ndajfolja *albanesische*, që në kohën e Vukut, nën ndikimin e italishtes, përdorehin në gjuhën gjermane.

Në Fjalorin e tij të vitit 1818 Vuk Karaxhiçi regjistroi edhe emrat etnikë të disa popujve, ndër ta edhe etnikët e ktetikët, pra edhe emrat e mbiemrat e popullit shqiptar. Dhe jo vetëm kaq, por ai regjistroi edhe disa patronime, toponime e fjalë të ngjashme të gjuhës shqipe, prandaj Fjalori i Vukut dhe vlera e tij i tejkalon kufijtë e gjuhës serbe, ai ka një rëndësi edhe për gjuhë të tjera.

Vuku në pjesën leksikore të gjuhës serbe, për të treguar pjesëtarët e popullit shqiptar, përdori emrat etnikë *Arnautin* (me kuptim 'shqiptar'), *Arnautka* ('shqiptare') dhe ktetikun *arnautski*, *-ka*, *ko*, (për kuptimet e mbiemrave 'shqip, -e; shqiptar,-e'); pastaj edhe foljen me *-iti*: *arnautiti* ('shqiptarizoj') dhe emrit foljor *arnaučenje* ('shqiptarizim'). Pra, i regjistroi në bazë të rrënjës së fjalës *Arnaut* dhe nga kjo shënoi edhe fjalët e zëna ngoje, kryesisht të formuara me anë të prapashtesave të gjuhës serbe. Në

* Këtë kumtesë e kam paraqitur në *Mbledhjen shkencore të sllavistëve në ditët e Vukut*, mbajtur në Beograd, më 11—16 shtator 1984 dhe është botuar me titullin „Etnička imena albanskog naroda u Vukovom Rječniku” në botimin e referateve dhe të kumtesave të kësaj mbledhjeje.

pjesën e gjuhës gjermane të Fjalorit ai përdori edhe fjalët përkatëse: *Albanese* dhe *Arnaut*; *Arnautin*; *albanesisch*; *Arnauten machen*; *das Albanisiren*; kurse në latinishte: etnikët *Albanus*, *Albana*; toponimin *Albania*, ndërsa mbiemrat e prejardhur, foljet dhe ndajfoljet i përktheu me fjalët përkatëse ose me shprehjet perifrastike: *albanus*, *-a*, *-um*; *facio esse Albanum*; *more albani*.

Sa i përket emrit etnik *Arnaut* dhe rrjedhojave të tij *Arnautin*, *Arnautka*, që i shënoi Vuku, duhet pasur parasysh se këto fjalë V. Karaxhiçi i mori nga turqishtja përkatësisht nga gjuha osmane me disa ndryshime të vogla të trajtave, do të thotë duke ia përshtatur gjuhës serbe me anë të prapashtesave të saja *-in* dhe *-ka*. Përveç kësaj, në gjuhën osmane dhe në turqishten e sotme për të treguar pjesëtarin e popullit shqiptar përdoret emri etnik *Arnavut*, kurse për Shqipërinë *Arnautluk*, ndërsi si ndajfolje përdoret *arnavutçe* me kuptim 'shqip, shqiptarçe'.

Pra, siç shihet, Vuk Karaxhiçi në gjuhën serbe të kohës së tij përdori ata emra etnikë për popullin shqiptar, të cilët përdorshin në gjuhën zyrtare të Perandorisë Osmane. Në atë periudhë këta emra etnikë dhe ktetikë janë përdorur edhe në gjuhët e tjera të sllavëve të jugut, kryesisht të atyre që gjendeshin në pjesën lindore të Gadishullit Ballkanik, madje në radhë të parë në gjuhët e folura popullore. Kuptohet se Vuk Karaxhiçi i është përmbajtur gjuhës popullore, pra edhe me këtë rast në pajtim me parimet e veta për lidhjen e ngushtë të gjuhës së folur popullore dhe të gjuhës letrare.

Mund të shtrohet pyetja se prej nga e heqin zanafillën emrat etnikë: *Arnaut*, *Arnautka*, e *mandej* edhe toponimi *Arnautluk*, respektivisht prej nga u përfatuan në osmanishten trajtat: *Arnavut*, *Arnavutluk*; a thua këta emra kanë lidhje gjuhësore me etnikët e gjermanishtes *Albanese*, *Albanin*, *Albanien*, dhe me trajtat e gjunës latine: *Albanus*, *Albana*, *Albania*, të cilat figurojnë në Fjalorin e Vuk Karaxhiçit.

Nëse e kemi të qartë se emrat etnikë: *Arnaut(in)*, *Arnautluk* si dhe fjalët e tjera të prejardhura në gjuhën serbe dhe në gjuhët e tjera fqinje sllave u përfatuan nga emrat e caktuar të turqishtes, respektivisht të gjuhës osmane: *Arnavut* (e kjo nga trajta e mëhershme *Arvanit*) *Arnavutluk*, pason çështja e shqyrtimit dhe e konstatimit si u përfatuan në gjuhën osmane emrat etnikë të zënë ngoje.

Lidhur me këtë çështje do vënë në spikamë faktin se parardhësit e shqiptarëve të sotëm gjatë periudhës së Perandorisë Bizantine në gjuhën greke rëndom quheshin: *Arvanitis* = *Arbanitis*; *Arbanitai* = *Arvanitai* etj.

Pikërisht nga ky emër etnik i greqishtes mesjetare u përftua emri i osmanishtes respektivisht i turqishtes *Arnavut* (më parë *Arvanit*), e kjo ndodhi me rënien fonetike të mbaresave *-is*, *-ai* (*-oi*) të gjuhës së huaj dhe nëpërmjet metatezës *v-n > n-v*, e pas-

taj me kalimin e zanores *i* në *u* kur kjo është në pozicion pas bashkëtingëllores *v* sipas harmonisë a përputhjes fonetike të gjuhës turke, sipas së cilës *v*-ja kërkon *u* (-*vu*). Kështu, pra, emri i greqishtes mesjetare: *Arvanit(-is)* në osmanishten u përftua në trajtat: *Arvanit* > *Arnavut*. Në të folur *v*-ja rëndom nuk dëgjohet në shqiptim të osmanishtes respektivisht të gjuhës turke. Përveç tjerash, dihet se gjuha greke ishte një ndër gjuhët me ndikim të madh dhe me prestigj të theksuar në periudhën e pushtimit turk në Gadishullin Ballkanik. Me fjalë të tjera, gjuha osmane në disa raste fjalët e huaja i huazoi nga greqishtja, veçanërisht emrat etnikë, siç është rasti me etnikun për të cilin këtu e kemi fjalën.

Huazimi i emrit etnik grek *Arvanitis/Arbanitis* në osmanishten pësoi një ndryshim të vogël fonetik. Me anë të tij e me anë të metatezës u përftua trajta *Arnavut* në gjuhën turke; e pastaj nga ky emër me prapashtesën e gjuhës turke *-luk* u formua toponimi *Arnavutluk* me kuptimin: „atdheu i shqiptarëve”, pra „Shqipëria”.

Nga ana tjetër, duke u mbështetur në këtë fakt e kemi lehtë të kuptojmë çështjen — përse Vuk Karaxhiçi në Fjalorin e tij i përdori emrat etnikë: *Arnaut*, *Arnautin*, *Arnautovac* dhe toponimin *Arnautluk*, në vend të emërtimeve mesjetare gjegjësisht të serbishtes së vjetër: *Arbanь*, *Arbьnь*, *Arbanas(in)*, *Raban*, mandej *Arbanija*. Rrokja *Ra-* në trajtën *Rabanь*, *Rabьnь*, në vend të rrokjes parësore: *Ar-* (në vend të trajtës *Arbanь*, *Arbьnь* u përftuan sipas metatezës së lëngëzoreve në gjuhët sllave.

Sa u përket emrave etnikë: *Albanese* (në kuptimin 'shqiptar') dhe ndajfoljes *albanesisch*, të cilën Vuk Karaxhiçi e shënoi në pjesën e leksikut të gjuhës gjermane, vlen të thuhet se në atë kohë nën ndikimin e gjuhës italiane këto fjalë përdroreshin edhe në gjermanishten në atë trajtë. Përndryshe, trajtat e sotme të drejta të këtyre fjalëve në gjuhën gjermane janë: *Albaner* ('shqiptar'), *Albanerinn* ('shqiptare'), *albanisch* ('shqip'), *Albanien* ('Shqipëria').

Ndoshta nën ndikimin e Vuk Karaxhiçit disa bashkëkohës të tij gjermanë, si edhe ata që shkruanin fill pas kohës së Vukut, i përdorën trajtat e Fjalorit të Vukut: *Albanese*, *albanesische*. Kështu, për shembull, R. Xylanderi më 1835 shkruan veprën „*Sprache der Albanesen oder Arnauten*”, J. G. Hani nga Vjena më 1854 boton veprën „*Albanesische Studien*”, G. Meyeri më 1891 „*Etymologisches Wörterbuch des albanesischen Sprache*” etj.

Emrat etnikë, për të cilët është fjala, në pjesën e Fjalorit për gjuhën latine Vuku i shënoi në formë standarde të kësaj gjuhe, si: *Albanus* ('shqiptar') *Albana* ('shqiptare') *Albania* ('Shqipëria'). Këto trajta, kryesisht u përhapën më parë në gjuhët romane, e më vonë edhe nëpër gjuhë të tjera. Kështu që këta emra sot janë bërë emra të përgjithshëm etnikë, kombëtarë. përkatësisht emër i shtetit shqiptar.

Një numër i madh shkencëtarësh, siç janë: J. G. Hani, E. Çabej, P. Skoku etj. janë të mendimit se emrat etnikë *Arbën* (*Arbër*); *Arbanitis*, *Albanitis*, *Alvanites*, *Arbanъ*, *Arbanas*; *Arnavut*, *Arnaut*; *Albanus*; *Albanesis*, *Albanenses*; *Albaner*; *Albanac* etimologjikisht rrjedhin prej emrit të lashtë etnik *Albanoi*, i cili për herë të parë përmendet në shekullin II të epokës sonë në veprën e P. Ptolemeut, gjeografit të njohur grek nga Aleksandria, si emër i fisit ilir që jetonte në Shqipërinë e sotme të mesme, përkatësisht emri i qytetit të tyre *Albanopolis*. Te Straboni, kuptohet po ashtu në kohën etnike, këtë emër etnik e ndeshim me trajtën *Albion*.

Vlen të vihet në dukje se Vuk Karaxhiçi në Fjalorin e tij tri-gjuhësh të ribotuar me plotësime në vitin 1852, përveç emrave etnikë të lartparaqitur, i ka shënuar edhe emrat etnikë në trajtën e serbishtes së vjetër si vijojnë: *Arbanas*, *der Albaner*, *Albanus* cf. *Arnautin* ('shqiptar-i'); *Arbanija*, *Albanien*, *Albania* (cf. *Arnautluk*) ('Shqipëri-a'); *arbanaski*, -a, -o, *albanesisch*, *albanicus* ('shqip-e, shqiptar-e' — si mbiemër).

Çështje tjetër është substitiuimi i bashkëtingëlloreve *l* dhe *r* në këtë emër etnik. Në të vërtetë, ekzistojnë dy mendime të kundërta se cila nga këto trajta është më e vjetër (me *l*: *Alban* — apo me *r*: *Arban*).

Po ashtu problem tjetër, që nuk hyn brenda caqeve të kësaj kumtese, është fakti se populli shqiptar, ndryshe nga popujt e tjerë të botës, sot e quan veten me emrat etnikë: *shqiptar*, *shqiptare*, (gjuhë) *shqipe*, (flas) *shqip* dhe vendin e tyre *Shqipëri-a* (*Shqipni-a*).

LITERATURA E PËRDORUR

1. Vuk St. Karadžić, *Srpski Rječnik*. . . u Beču, 1818.
2. G. Meyer, *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strassbur, 1891.
3. P. Skok, *Etimologijski rječnik hrvatskog ili srpskog jezika*, I, Zagreb, 1971.
4. E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, II, Tiranë, 1976.
5. K. Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht*, Athinë, 1904 (ributim Tiranë, 1961).
6. K. Jireček, *Istorija Srba*, I, Beograd, 1952.
7. G. Skrivanić, *Imenik geografskih naziva srednjovekovne Zete*, Titograd, 1959.
8. G. Elezović, *Rečnik Kosovsko-metohijskog dijalekta*, I, Beograd, 1932.
9. Vuk St. Karadžić, *Srpski Rječnik*, u Beču, 1852.

Latif Mulaku

ETHNISCHE NAMEN DES ALBANISCHES VOLKS IN DEM
WÖRTERBUCH VON VUK KARADŽIĆ

Z u s a m m e n f a s s u n g

Vuk hat in seinem dreisprachigen Wörterbuch des Jahres 1818 folgende ethnische Namen des albanisches Volks aufgenommen: *Arnautin* („Albaner“), *Arnautka* („Albanerin“), dannach Wörter: *arnautski*, *a,o*, („albanisch-e“), *arnautiti* („albanesieren“), *arnaučenje* („Albanisierung“). Im deutschen Teil: *Albanese* und *Arnaut*, *Arnautin*; *Albaniens*; *Arnauten machen*; *das Albanaisieren*; und im lateinischen Teil: *Albanaus*, *Albana*,; *albanus -a, -um*; *facio esse Albanum*; *more albani*.

Der Verfasser des Wörterbuches hat also in der deutschen Sprache die ethnischen Namen für des albanische Volk aufgenommen, die im Türkischen Reich verwendet wurden. Diese ethnische Namen der osmanische Sprache sind aus der griechischen mittelalterlichen. Sprache: *Arvanit/is*, *Arbanit/is*, *Arvanit/es*, *Arvan/oi* nach den Veränderungen der phonetischen Regeln der türkischen Sprache, beziehungsweise des Osmanischen: gr. *Arvanit/is* > tür. *Arnavit* (mit Metathesa), danach *Arnavut* (nach der phonetischen Harmonie des Osmanischen: *-vi->-vu-*).

